



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:060310
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05498409

Ac.nr.7655/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. nga komuna Prizren, të cilin e përfaqëson me autorizim S.M.N., avokat me seli në Komuna Prizren, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, MASHT me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen për shkak të kompensimit të shujtave për ditët në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1070/2022 datë 27.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, MASHT me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1070/2022 datë 27.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1070/2022 datë 27.10.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për

vitin 2021, për 272 ditë pune prej datës 01.01.2021 deri 31.12.2021, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 544.00 euro, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (29.03.2022) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm...”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi A.K. nga komuna Prizren, të cilin e përfaqëson me autorizim S.M.N., avokat me seli në Komuna Prizren, me datë 29.03.2022, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, MASHT me seli në Komuna Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë me datë 27.10.2023, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.1070/2022 datë 27.10.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar si vijon: “... Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditësit në harmoni me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, me të cilën parashihet se “Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren. Nga vërtetimi i lëshuar nga Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren, me numër reference 132/2022 i datës 17.03.2022 vërtetohet se paditësi për vitin 2021 ka realizuar gjithsej 272 ditë pune, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumë më si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Lidhur me shumën e kompensimit të ushqimit në punë, Gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, dhe e datës 22.01.2021, andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a)*

organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Po ashtu pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar me nenin 35, paragrafi 5, 7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare nuk qëndron pasi që Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të pagave për shujta i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Andaj sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe e datës 22.01.2021, përcaktohet se: “ *1.Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut*”, ndërsa me 5 nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “*Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2022:060310
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05498409

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7655/2023 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi